

Prishtinë, 27 dhjetor 2023

Nga: Taulant Hoxha, Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)
Për: z. Albin Kurti, Kryeministër i Republikës së Kosovës
CC: z. Besnik Bislimi, zv. Kryeministër i parë i Qeverisë së Republikës së Kosovës
z. Elbert Krasniqi, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal

I nderuar Kryeministër Kurti,

Shpresojmë që jeni mirë me shëndet e punët po ju ecin mbarë!

Po ju shkruajmë pas mbledhjes së 180-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës të mbajtur sot, më 27 dhjetor 2023, gjatë së cilës keni miratuar, ndër të tjera, edhe **Projektligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës** (më tutje: PL për pronën komunale).

Qeveria e Republikës së Kosovës më herët gjatë këtij viti kishte përcaktuar qëllimin dhe orientimet e politikave të Qeverisë në këtë fushë nëpërmjet Koncept-Dokumentit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, i miratuar nga Qeveria e Kosovës më datë 8 mars 2023. Në përputhje me sistemin politikë-bërës në Kosovë dhe procedurat e hartimit të akteve normative, ka qenë detyrë e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Grupit Punues për hartimin e PL për pronën komunale që qëllimin dhe orientimet e politikave të përcaktuara në Koncept Dokument t'i normojë nëpërmjet aktit të ri normativ, pa ndërhyrë në përmbajtjen e këtyre orientimeve.

Fatqësisht, përmbajtja e PL për pronën komunale i miratuar nga Qeveria në mbledhjen e sotme është në kundërshtim të plotë me përmbajtjen dhe qëllimet e politikave të Qeverisë së Kosovës të përcaktuara me këtë Koncept Dokument. Përkundrazi, Projektligji për pronën komunale, në përmbajtjen që është aprovuar nga Qeveria, vetëm se i përsërit dhe shumëfishon problemet e shumta të Ligjit aktualisht në fuqi, e të cilat janë evidentuar si në vlerësimin Ex-post të këtij ligji ashtu edhe në diskutimet e shumta e të thella gjatë hartimit të Koncept Dokumentit.

PL për pronën komunale, në përmbajtjen që është aprovuar sot nga Qeveria, e injoron qëllimin kryesor të përcaktuar me Koncept Dokument për zhvillim të qëndrueshëm nëpërmjet shfrytëzimit të pronave komunale për të përmbushur nevojat e qytetarëve dhe komunitetit; e injoron kërkesën e Koncept Dokumentit për të përcaktuar qëllimin dhe kriteret dhe format e përshtatshme për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale; dështon t'i përcaktojë kriteret minimale të transparencës së procesit të dhënies në shfrytëzim të pronave komunale; dështon t'i përcaktojë kërkesat minimale për përmbajtje të kontratave për shfrytëzim dhe mekanizmat e mbikëqyrjes së zbatimit të kontratave për shfrytëzim të pronave komunale; mundëson vazhdimin e kontratave për shfrytëzim pa kriteret të qarta; diskriminon qytetarët dhe komunitetin si shfrytëzues potencial të pronave komunale për qëllime të zhvillimit komunitar, duke i dhënë përparësi absolute subjekteve komerciale që kanë kapacitete të pakufizuara financiare në ankandet ku çmimi është kriter përcaktues; si dhe në përgjithësi injoron parimet e përcaktuara me Koncept Dokument për shfrytëzimin e pronave komunale sipas procedurave të hapura, pjesëmarrëse dhe transparente.

Për informimin tuaj, përkundër përfshirjes tonë thelbësore në hartimin e Koncept Dokumentit, as nuk jemi informuar e as nuk jemi përfshirë në procesin e hartimit të PL për pronën komunale. Përkundër kësaj, me t'u informuar për këtë proces dhe sapo kemi pasur mundësi ta analizojmë përmbajtjen e PL për pronën komunale të publikuar për konsultim publik në nëntor 2023, bashkë me shumë organizata tjera të shoqërisë civile kemi dorëzuar analizë të detajuar të problemeve përmbajtësore dhe kemi shprehur gatishmërinë për të kontribuar në

trajtimin e duhur të çështjeve të ngritura.¹ Fatkeqësisht, asnjëherë nuk kemi marrë përgjigje nga MAPL. Sot u befasuam kur nga mediat kuptuam që PL për pronën komunale ishte vendosur në rend dite për aprovim në mbledhje të Qeverisë, e sidomos kur e kuptuam që përmbajtja e parashtruar për aprovim nuk kishte pësuar gati së asnjë ndryshim përmbajtësor nga verzioni problematik i shpallur për konsultim publik.

Tashmë që ky proces ka marrë epilog në nivelin e Qeverisë së Kosovës, mbetemi jashtëzakonisht të zhgënjyer me qasjen e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Qeverisë së Kosovës si ndaj injorimit të kërkesave të Koncept Dokumentit të miratuar nga vet ju, e po ashtu edhe ndaj qasjes së mbyllur dhe jo-bashkëpunuese ndaj partnerëve të shoqërisë civile, të cilët me konstruktivitetin maksimal dhe me të gjitha kapacitetet e veta i janë ofruar vendim-marrësve që të japin kontributin e tyre në këtë proces.

Përkundër të gjitha këtyre problemeve të renditura më lart, duam të besojmë që megjithatë mbetet qëllim dhe interes i Qeverisë së Kosovës që orientimet e politikave të përcaktuara me Koncept Dokument të jetësohen në praktikë, pra pronat komunale të shfrytëzohen për zhvillimin e qëndrueshëm lokal, duke përfshirë komponentën ekonomike, sociale, kulturore dhe atë të mbrojtjes së mjedisit. Për këtë arsye, ne do të angazhohemi në kuadër të procedurave parlamentare në Kuvendin e Kosovës që ky projektligj të kthehet në binarët e duhur, brenda kornizave të Koncept Dokumentit të miratuar nga Qeveria e Kosovës, ose të kthehet përsëri në shqyrtim në Qeveri. Për këtë, presim përkrahje nga ju.

Me respekt,

Taulant Hoxha

Drejtor Ekzekutiv

¹ Bashkëngjitur: Kërkesa e grupit të OShC-ve drejtuar Ministrit Krasniqi më datë 15 nëntor 2023, bashkë me shpjegimin e problemeve përmbajtësore të PL për pronën komunale